

Teuta SHALA

AKTIVITETET E INSTITUTIT TË HISTORISË GJATË VITEVE 2008-2009

I. Simpoziumet, Konferencat Shkencore

Në periudhën kohore 2008-2009, Instituti i Historisë Prishtinë, në fushën e aktiviteteve shkencore arriti që të organizoi Simpoziume dhe Konferenca Shkencore, duke dhënë ndihmesë të madhe në ndriçimin e problemeve të shumta nga fusha e historisë dhe e historiografisë shqiptare në përgjithësi.

1.1.Simpoziumi Shkencor kushtuar jetës dhe veprës së Akademik Ali Hadrit me rasti ne 80-vjetorit të lindjes së tij

Në 80- vjetorin e lindjes së Akademik Ali Hadrit, Instituti i Historisë-Prishtinë në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës si dhe me Departamentin e Historisë së Fakultetit Filozofikë të UP-së, organizuan më 3 mars 2008 në Prishtinë Simpoziumin shkencor “Jeta dhe vepra e Akademik Ali Hadrit”. Simpoziumin e hapi kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, akademik Rexhep Ismajli, i cili theksoi se akademik Ali Hadri i takon brezit i cili mori peshën e organizimit të rezistencës shqiptare sidomos në veprimtarinë shkencore. Pas tij punimet e simpoziumit i përshëndetën: zëvendës ministri i Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë z. Agim Hyseni dhe Prof. dr. Marengelen Verli, Drejtor i Institutit të Historisë –Tiranë.

Për jetën dhe veprimtarinë shkencore e patriotike të akademik Ali Hadrit referuan 24 studiues nga Kosova dhe Shqipëria. Ata e vlerësuan lartë figurën e akademik Ali Hadrit, si dhe kontributin që ai dha si në aspektin patriotik në përgjithësi ashtu edhe në fushën e arsimit e të shkencës në veçanti.

Serinë e kumtesave të këtij simpoziumi e hapi drejtori i Institutit të Historisë –Prishtinë prof.dr. Jusuf Bajraktari(Prishtinë), me kumtesën “Akademik Ali Hadri shkencëtar dhe patriot i shquar”. Më pas prof. dr. Kristaq Prifti (Tiranë), paraqiti temën: “ Akademik Ali Hadri në përballje me historiografinë jugosllave në redaksinë e Enciklopedisë së Jugosllavisë në vitin 1980”, i cili vuri në dukje se Ali Hadri në gjithë veprimtarinë e tij u angazhua në luftën për mbrojtjen e vlerave historike-kulturore të shqiptarëve të Kosovës dhe të kombit shqiptar në tërësi.

Krahas mbrojtjes të së vërtetës shkencore, Ali Hadri nuk qëndroi duarkryq as përballë ngjarjeve që po zhvilloheshin në Kosovë në kohën kur ai jetoi e veproi. Për shkak të ideve përparimtare që kishte, pushteti i atëhershëm jo vetëm që e kishte vënë nën shënjestër, por edhe e akuzonte për shumë ngjarje që në atë kohë po zhvilloheshin në Kosovë. Kështu menjëherë pas demonstratave të vitit 1981, Ali Hadri do të jetë ndër të parët që u ndesh me pasojat e diferencimit ideopolitik, duke u përjashtuar nga LKJ, largimi nga Universiteti, redaksitë e revistave dhe të botimeve, komisionet e ndryshme, ndalimi i botimit të punimeve dhe veprave, nxjerrja nga përdorimi i teksteve të tij shkollorë të historisë, moslejimi i pjesëmarrjes në tubimet shkencore. Të gjitha këto me mjaft përkushtim trajtohen në kumtesën “Ali Hadri përballë diferencimit ideopolitik të intelektualëve shqiptarë”, të studiuesit prof. dr. Zekeria Cana.

Akademik Ali Hadri edhe pse fushë të ngushtë të studimit nuk e kishte historinë e antikes dhe atë mesjetare, megjithatë shkrimet e tij kushtuar problemeve të rëndësishme që i karakterizojnë periudhat në fjalë me plot të drejt mund të konsiderohen si punime unike për historinë dhe historianët.

Nga lëmi i historisë së antikës, prof. dr. Edi Shukriu, në punimin “Kontributi i akademik Ali Hadrit në trajtimin e historisë antike”, krahas shkrimeve të shumta nga kjo lëmi, veçon sidomos rolin që ai luajti në përfshirjen e lëndës së arkeologjisë në Degën e Historisë në Universitetin e Prishtinës.

Kur jemi te kontribut i prof. Ali Hadrit për historinë e antikës, padyshim se një rëndësi të jashtëzakonshme kanë edhe shkrimet e tij kushtuar ilirëve. Për rolin e tij në këtë aspekt, mr. Arben Arifi në punimin: "Shkrimet e Ali Hadrit për Ilirët", vë në dukje se shkrimet për ilirët, për autorët kosovarë ishin shumë të rralla ose nuk ekzistonin fare. Kështu prof. Ali Hadri është njëri ndër të parët që hedh dritë dhe nis një punë shumë të madhe duke përcjell vazhdimësinë e pandërprerë nga ilirët deri te shqiptarët.

Krijimtarinë shkencore të Ali Hadri e pasurojnë dhe e begatojnë edhe shkrimet nga periudha mesjetare shqiptare, e në veçanti periudha e lavdishme e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Krahas shkrimeve, për ndriçimin e figurës së Skënderbeut, ai u dallua edhe në organizimin e Konferencave Shkencore, siç është rasti me Konferencën Shkencore të mbajtur në Prishtinë me 9 - 12 maj 1968, kushtuar 500 vjetorit të vdekjes së Skënderbeut. Nga periudha në fjalë studiuesi Ali Hadri ka lënë një bagazh të pasur të punimeve të cilat janë të botuara si në tekste shkollorë ashtu edhe në revista të ndryshme shkencore. Ky segment mjaft i rëndësishëm i krijimtarisë së Ali Hadrit trajtohet në punimin e mr. Bedri Muhadrit: "Vështrim mbi studimin e Ali Hadrit për Epokën e Skënderbeut".

Në opusin shkencor të profesor Ali Hadrit, dallohet sidomos kontributi i tij për periudhën në mes të dy luftërave botërore në përgjithësi dhe për Luftën e Dytë Botërore në veçanti. Studiuesja prof. dr. Emine Arifi-Bakalli, në punimin: "Kontributi i profesor Ali Hadrit për periudhën ndërmjet dy Luftërave Botërore", duke elaboruar për këtë problem vjen në përfundim dhe është e mendimit se profesor Ali Hadri, me punimet shkencore që kanë të bëjnë me periudhën në fjalë, hapi shtigje dhe trasoi rrugë për studime të reja, dhe se këto studime janë dëshmi se profesor Ali Hadri, që në fillimet e punës hulumtuese-shkencore ka pasur "vetëdijen e duhur shkencore për kuptimin e historisë".

Ali Hadri, jo vetëm që i vuri themele të forta historiografisë sonë që po lindte e sidomos historisë së Luftës së Dytë Botërore në përgjithësi por i vuri themele të forta edhe historisë së Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe kritikës historiografike në veçanti. Kështu është vlerësuar kontributi i Ali Hadrit në punimin e prof. dr. Fehmi Rexhepit: "Lufta e Dytë Botërore në opusin e Ali Hadrit".

Në zhvillimin e shkencës së historisë, Ali Hadri krahas veprave dhe shkrimeve të shumta, ndihmesë të madhe në këtë aspekt dha edhe me punën e tij si kryeredaktor dhe redaktor në revistat shkencore. Për një kohë relativisht të gjatë ai ishte kryeredaktor i tri revistave shkencore: "Përparimi" (1957), "Gjurmime Albanologjike" (1962) dhe "Kosova" (1972), që filluan të botoheshin në Kosovë që nga vitet e 50 të shekullit të kaluar. Roli i Ali Hadrit në këto revista vihet në pah në punimin e studiueseve prof. dr. Drita Gunga & prof. dr. Sulltane Ukaj.

Në kontributin shumë dimensional të Akademik Ali Hadrit, një vend meritore zënë edhe polemikat e tij rreth themelimit të PKSH-së dhe rreth përhapjes së islamit në Maqedoni. Shkrimet e kësaj natyre patën një jehonë të madhe, e veçanërisht në këtë aspekt spikat polemika e zhvilluar në vitet '70' me S. V. Tempon për çështjen e themelimit të PKSH-së e cila jehoi jo vetëm në Shqipëri e në Kosovë por edhe në Jugosllavi e më gjerë. Kjo polemikë u trajtua me një kujdes e përkushtim në punimin e studiuesi nga Tirana prof. dr. Xhelal Gjeçovi.

Në mesin e viteve të tetëdhjeta të shekullit të kaluar, akademik Ali Hadri me guximin prej një intelektualit të mirëfilltë, zhvilloi edhe një polemikë me Njazi Limanovin rreth përhapjes së islamit në Maqedoni, duke hedhur poshtë tezat e paqëndrueshme të tij. Në polemikën e tij ai vuri në spikamë pesë prej tezave të cilat ishin antishkencore dhe që e njollosnin në masë të madhe popullin shqiptar. Kjo çështje është objekt studimi në punimin e mr. Qemajl Morinës: "Polemika e akademik Ali Hadrit me Njazi Limanovin rreth përhapjes së Islamit në Maqedoni".

Me punën dhe përkushtimin e tij ndaj shkencës Ali Hadri la gjurmë të pashlyeshme edhe në fushën e arsimit duke kontribuar fillimisht si mësues pastaj si profesor në shkollën Normale, dhe më vonë Ligjërues në Universitetin e Prishtinës. Nga kjo fushë e veprimtarisë së tij më rëndësi është edhe roli që ai luajti në hartimin e teksteve dhe plan programeve mësimore për shkollat fillore dhe të mesme.

Kontributi i Ali Hadrit në këtë aspekt pasqyrohet në punimin e mr. Frashër Demaj: "Kontributi i profesor Ali Hadrit në fushën e arsimit". Ali Hadri u shqua edhe për politikën e tij në fushën e arsimit e të shkencës. Punim i prof. dr. Fazli Sylës: "Kontributi i Ali Hadrit në politikën arsimore e shkencore të Kosovës", ndriçon këtë segment mjaft të rëndësishëm të veprimtarisë së Ali Hadrit.

Në fushën e arsimit Ali Hadri, u angazhua edhe në aftësimin dhe ngritjen e kuadrove të reja shkencore. Nga punim i prof. dr. Isa Bicaj, kushtuar rolit të Ali Hadrit në këtë aspekt, në periudhën që ai e udhëhoqi katedrën e historisë magjistruan 64 dhe doktoruan 11 kandidatë.

Pavarësisht pengesave që bëri pushteti i atëhershëm e sidomos pas vitit 1981, ai nuk preferoi që të rrinte duarkryq, veprimtaria shkencore e publicistike e Ali Hadrit është prezentë edhe pas këtij viti. Për trashëgimin publicistike të Ali Hadrit pas vitit 1981, të dhëna me interes na ofron punimi i prof. dr. Ymer Jakës.

Në veprimtarinë e akademik Ali Hadri, vend me rëndësi zënë edhe përpjekjet e tij për emancipimin dhe përparimin e femrës shqiptare. Pikërisht për ndihmë e jashtëzakonshëm që prof. Ali Hadri ka dhënë për emancipimin dhe përparimin e femrës shqiptare, prof. dr. Fatmira Musaj në punimin e saj: “Probleme të gruas në veprat e prof. Ali Hadrit”, shprehet se duhet t’i jemi thellësisht mirënjohës akademik Ali Hadrit për këtë ndihmë, dhe në këtë eveniment përkujtimor, përulemi me respekt e nderim para figurës dhe veprës së tij.

Veprimtaria e Ali Hadrit, në fakt ka qenë e madhe dhe gjithnjë e fokusuar në çështje të rëndësishme, duke e bërë atë të dallohet jo vetëm si shkencëtar po edhe si atdhetar i devotshëm. Veprimtaria e tij atdhetare doli në pah edhe gjatë viteve të 80-ta të shekullit të kaluar kur profesor Hadri u vu në mbrojtje të simboleve kombëtare. Ky segment i rëndësishëm i veprimtarisë së tij atdhetare gjeti një trajtim gjithëpërfshirës në punimin e prof. dr. Sabile Keçmezi- Basha.

Vend meritore sa ju përket studimeve dhe publikimeve të akademik Ali Hadrit, zë edhe kontributi i tij në ndriçimin e reformës agrare dhe kolonizimit të Kosovës, procese këto që janë pasqyruar në kumtesën e mr. Mehmet Gjoshaj.

Në veprimtarinë e tij krijuese, Ali Hadri kujdes të veçantë i kushtoi edhe përzgjedhjes dhe mënyrës së trajtimit të çështjeve historike. Këtij problemi vëmendje e veçantë i kushtohet në punimin e prof. dr. Izber Hotit.

Me kontributin e tij shumë dimensional në fushën e shkencës, Ali Hadri ka dhënë ndihmesë të jashtëzakonshme edhe në fushën e religjionit. Kjo ndihmesë e Ali Hadrit, në këtë fushë, u trajtua në punimin e prof. dr. Haki Kasumit:” Ndhimesa e Ali Hadrit në trajtimin e fesë”.

Kontributin madhor të akademik Ali Hadrit në fushën e shkencës më së miri e dëshmon bibliografia e botimeve të tij, e cila u prezantua në kumtesën e Arbër Hadrit “Bibliografia e punimeve të Ali Hadrit “. Fjalën e mbylljes së simpoziumit e mbajti prof.dr. Jusuf Bajraktari drejtor i Institutit të Historisë –Prishtinë, i cili në mes tjerash veçoi se akademik Ali Hadri është njëri prej historianëve më të mëdhenj dhe më të merituar që ka pasur kombi ynë në të gjitha kohërat.

1.2. Konferenca Shkencore kushtuar Lidhjes Shqiptare të Prizrenit 1878-1881, me rastin e 130 vjetorit të krijimit

Në kuadër të shënimit të 130 – vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, në Prishtinë u mbajtën një sërë manifestimesh për shënimin e këtij evenimenti të rëndësishëm të historisë sonë kombëtare. Shënimi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, përkatësisht i 130-vjetorit të saj kishte dimensione dhe vlera të veçantë, për faktin se po kremtohej në vitin e Pavarësisë së Kosovës.

Për kremtimin sa më madhështor të këtij jubileu, në mbrëmjen e 9 qershorit 2008, në Teatrin Kombëtar në Prishtinë, nën patronatin e presidentit të Republikës së Kosovës, z. Fatmir Sejdiu u mbajt Akademia solemne kushtuar 130-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Në fjalën e rastit që e mbajti në këtë Akademi Presidenti Sejdiu theksoi se Lidhja e Prizrenit drejtoi edhe mesazhin bashkëpunues me të gjithë popujt dhe vendet liridashëse, të cilat ftoheshin të pranonin ëndrrën e një populli, i cili merrte përsipër detyrimet dhe përgjegjësitë për të ardhmen e vendit të vet.

Për këtë ngjarje madhore të së kaluarës tonë një fjalë rasti e mbajti edhe kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, akademik Rexhep Ismajli, i cili potencoi se përvjetorët si ky, janë raste të mira për të pasqyruar sa më objektivisht të kaluarën tonë.

Shënimi i 130-vjetorit të LSHP-së vazhdoi me konferencën dy ditore me karakter ndërkombëtar me temë: “Lidhja Shqiptare Prizrenit 1878-1881”, e cila u organizua nga Instituti Historisë -Prishtinë në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, me 10-11 qershor 2008 në Prishtinë, në të cilën referuan 37 studiues nga: Prishtina, Prizreni, Tirana, Shkupi, Ulqini, SHBA-të, Stambolli, Lubjana, Sofja, Vjena, Graci dhe Ammani.

Fjalën e hapjës së Konferencës Shkencore e mbajti prof.dr. Jusuf Bajraktari drejtor i Institutit të Historisë-Prishtinë, i cili u shpreh se organizimi i kësaj konference shkencore ka për qëllim prezantimin e njohurive dhe afirmimin e vlerësimeve të reja për njëri nga ngjarjet më të rëndësishme për historinë kombëtare shqiptare.

Punimet e Konferencës i përshëndetën: ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë prof.dr. Enver Hoxhaj, ku sipas tij programi politik dhe nacional i LSHP-së, i cili bazohet në tri shtylla kryesore: në pavarësi politike, tërësi politike e territoriale dhe në identitet kombëtar shqiptar, ka qenë dhe mbetet edhe sot e kësaj dite promotor dhe shtrat për të gjitha aktivitetet dhe programet e lëvizjeve tona politike të mëvonshme. Ndërkaq, kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës akademik Rexhep Ismajli, në fjalën e tij përshëndetëse theksoi se “Duke marrë parasysh angazhimin dhe punën e deritashme të studiuesve, sidomos të atyre që janë paraqitur në këtë konferencë, do të ketë një sukses të plotë”. Punimet e konferencës i përshëndeti edhe kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akademik Teki Biçoku. Sipas tij LSHP-ja e themeluar në Prizren nga personalitete më të shquara shqiptare të asaj kohe, u shndërrua në një platformë politike mbarëshqiptare që e shtriu ndikimin në të gjitha viset shqiptare.

Në ditën e parë të konferencës e cila ishte e ndarë në tri sesione punimet filluan me kumtesën e Pajazit Nushit (Prishtinë), “Vetëdija kulturore dhe politike e shqiptarëve në kohën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit”, i cili foli për rrethanat kulturo-historike të cilat kanë qarë deri te Kuvendi i Lidhjes më 10 qershor 1878.

Në kumtesën e tij “Lidhja shqiptare e Prizrenit projekt për shtetin kombëtar” prof.dr. Jusuf Bajraktari (Prishtinë), tha se një nga ngjarjet që i dha popullit shqiptar një përgjigje që zë vend nderi në histori është themelimi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Pikërisht në kuvendet e Lidhjes dhe në veprimet e saj u afirmua ideja për projektin e shtetit shqiptar me orientime të qarta të qytetërimit perëndimor, theksoi ai.

Studiuesi Kristaq Prifti (Tiranë), paraqiti kumtesën “Nga lidhja Shqiptare e Prizrenit te Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë dhe e Kosovës”. Studiuesi Ferid Duka (Tiranë), referoi kumtesën “Lidhja Shqiptare e Prizrenit në kontekstin e marrëdhënieve shqiptaro-osmane”. Në të ai bëri një kronologji të zhvillimit të ngjarjeve të LSHP-së, duke

përfshirë edhe vlerësimet e shtypit të kohës, deri te shtypja e saj nga forcat e Dervish Pashës.

Për rolin e Italianëve në zgjimin kombëtar shqiptar 1878-1912, referoi studiuesi nga SHBA-të Bernd Fischer (SHBA), i cili në mes tjerash theksoi se është kënaqësi për të që merr pjesë në këtë konferencë shkencore, e cila për herë të parë po mbahet në Kosovën e pavarur. “Trajtimi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në historiografinë sovjetike”, ishte kumtesa të cilën e trajtoi prof. dr.Zekeria Cana (Prishtinë), i cili duke marrë për bazë librin e studiuesit Irina Sinkijeviq, vuri në pah qëndrimin dhe veprimin e Rusisë që ta zhvishte LSHP-në nga karakteri kombëtar për t’ia veshur atë fetar.

Studiuesi Yüksel Çelýk,(Stamboll), në referatin e tij ” Qëllimi i formimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit”, duke u bazuar në dokumentet osmane u ndal tek ajo sesi e ka shikuar Porta e Lartë LSHP-në. Studiuesi Bozo Repe (Lubjan), prezantoi kumtesën “Sllovenët dhe Lidhja Shqiptare e Prizrenit”, ndërkaq Serguey Roussev (Sofje), në kumtesën e tij u përqendrua tek marrëdhëniet bullgaro-shqiptare në kohën e Lidhjes së Prizrenit.

Eva Frantz, studiuese nga Vjena, paraqiti kumtesën “Roli i mirditorëve në konfliktin me Mehmet Ali Pashën në Gjakovë”, ku në mes tjerash ajo u ndal edhe te statusi social dhe ai fetar i fanëve katolik në rajonin e Prizrenit dhe Gjakovës.

Prof.dr.Fehmi Rexhepi (Prishtinë), në kumtesën” Lidhja Shqiptare e Prizrenit sipas konsujve francez në Shkodër”, duke u bazuar në dokumentet e arkivit të Kosovës, vuri në dukje mospërputhjen e intereseve franceze të asaj kohe me zhvillimet në trevat shqiptare.

Studiuesi i radhës Martin Prochazka (Grac), në trajtesën e tij krahas Lidhjes së Prizrenit kujdes dhe vëmendje të veçantë i kushtoi edhe strategjisë ballkanike si dhe diplomacisë austro-hungareze. Luan Maltezi (Tiranë), në kumtesën “Epopeja e Skënderbeut dhe Rilindja Kombëtare Shqiptare,” foli për frymëzimin që kishte ngjallur epoka Skënderbeiane për kthimin e krenarisë kombëtare në periudhën e Rilindjes.

Për imazhin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në Lindjen e Mesme në periudhën kohore 1978-2008, referoi studiuesi Muhamed Mufaku (Amman). Ndërkaq veprimtaria e degës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në Prishtinë, ishte objekt studimi në kumtesën e studiuesit Iljaz Rexha (Prishtinë).

Të dhëna me interes nga raportet konsullore austro-hungareze për Ymer Prizrenin, njërin ndër protagonistet kryesor të Lidhjes së Prizrenit, na ofron kumtesa e studiuesit nga Tirana Prof. dr.Marengelen Verli (Tiranë).

Për koncepti e nacionalizmit si fenomen historiografik, referoi Dritan Egro(Tiranë), ndërsa për unitetin kombëtar në kohën e Lidhjes Shqiptare të Prizreni, referoi Prof. dr. Muhamet Shatri (Prishtinë). Mr.Frasher Demaj(Prishtinë), prezantoi temën "Qëndrimi i konsujve anglez në Prizren dhe Shkodër ndaj Lidhjes Shqiptare të Prizrenit".

Lidhja shqiptare e Prizrenit u pasqyrua edhe në shtypin e huaj të asaj kohe, pikërisht për këtë flasin tri kumtesat në vazhdim. Kumtesa e Jusuf Buxhovit (Prishtinë), vë në pah pasqyrimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në Shtypin gjerman të kohës, ndërsa ajo e prof.dr.Isa Bicajt (Prishtinë), na ofron të dhëna për vendin që zuri Lidhja Shqiptare e Prizrenit në gazetën "Gllas Crnogorca", kurse për prezantimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në revistën "Al Xhenan" të Bejrutit 1878-1881", referoi Qemajl Morina (Prishtinë).

Për Vilajetin e Janinës në kohën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit 1878-1881, referoi Shkëlzen Raça (Prishtinë). Në vazhdim referuesja e radhës Ledia Dushku (Tiranë), duke folur për bashkëpunimin shqiptaro-grek, ajo në mënyrë të veçantë u ndal tek dilemat e Megalidesë(1877-1878). Ndërkaq, për bisedimet sekrete në mes të Fuqive të Mëdha gjatë Luftës Ruso-Turke 1877-1878, referoi Albina Drançolli (Prishtinë). Dr. Lush Culaj (Prishtinë), në trajtesën e tij kujdes dhe vëmendje të veçantë i kushtoi rivaliteti diplomatik në mes Austro-Hungarisë dhe Italisë në kohën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Me kumtesën e studiuesit nga Ulqini Nail Draga (Ulqin), "Çështja e Ulqinit në gjeopolitikën e Fuqive të Mëdha(1880)", u mbyllën punimet e ditës së parë të kësaj konference shkencore.

Punimet e ditës së dytë të Konferencës Shkencore kushtuar 130 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit u hapën me kumtesën e dr. Muhamet Pirraku (Prishtinë)"Roli i fesë në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit", më pas referatet e tyre i lexuan edhe këta studiues: Dr. Ramiz Abdyl (Shkup),"Jashar bej Shkupi veprimtar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit" Prof. dr. Gazmend Rizaj (Prishtinë), në kumtesën e tij "Figura e Prenk Bib Dodes nga prizmi i diplomacisë angleze (1876-1878)", vuri në dukje se roli i Prenk Bibë Dodës dhe kryengritjes së mirditorëve duhet

parë si një reagim normal për kohën dhe jo si kundërvënje ndaj Lëvizjes së Lidhjes së Prizrenit. Ndërkaq referuesi i radhës dr. Xheladin Shala (Prishtinë), duke folur për rolin e Ymer Prizrenit në Lidhjen Shqiptare, në mes tjerash tha se Ymer Prizreni është presidenti i parë i Shqipërisë etnike.

Dr. Daut Bislimi(Prishtinë), vuri në pah trajtimin e Lidhjes së Prizrenit nga ana e historiografisë shqiptare.

Studiuesja prof.dr. Sabile Basha (Prishtinë), në kumtesën "Lidhja Shqiptare e Prizrenit në programin e organizatave ilegale në Kosovë", vuri në dukje se idetë dhe programi për çlirim dhe bashkimin kombëtar i nisur nga Kuvendi i LSHP ka qenë pjesë e të gjitha programeve politike të shumë organizatave atdhetare ilegale në Kosovë që nga viti 1945 e deri më 1990. Referuesi i radhës Riza Sadiku (Prishtinë), në kumtesën "Shënimi i përvjetorit të Lidhjes së Prizrenit në mërgatën shqiptare në SHBA", foli për shënimin e 80 dhe 100-vjetorit të LSHP në SHBA, si dhe për aktivitetet e ish të përndjekurve politikë shqiptarë në SHBA.

Për vlerat e ekspozitës së vitit 1978, kushtuar 100-vjetorit të Lidhja Shqiptare e Prizrenit, foli prof. dr. Jusuf Osmani (Prishtinë). Ndërkaq referuesi i fundit i kësaj konference Parim Kosova (Prizren), duke folur për kulturën materiale të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, vuri në dukje se kjo ngjarje ka trashëguar edhe vlera të kulturës materiale, ndër të cilat ai përmendi ndërtesën e Postë-Telegrafit, kompleksin e Gazi Mehmet Pashës, Kafën e Marashit e të tjera.

Në fund, kryetari i Këshillit Organizues të kësaj Konference prof. dr. Pajazit Nushi e paraqiti fjalën e mbylljes. Ai pasi bëri një rezymë të zhvillimeve të punimeve të konferencës së përmendur, në mes tjerash rikujtoi se ende ka vend për hulumtime në kontekst të LSHP.

1.3.Konferenca Shkencore kushtuar demonstratave të vitit 1968 me rastin e 40 -vjetorit

Më rastin e 40-vjetorit të demonstratave të vitit 1968 më 24 dhe 25 nëntor 2008, Instituti i Historisë-Prishtinë dhe Instituti Albanologjik në bashkëpunim me Shoqatën e të Burgosurve politikë, organizuan konferencën dyditore në Prishtinë. Nëpërmes temave të referuara në

këtë konferencë u pasqyrua gjendja politike, shkencore, kulturore, ekonomike e më gjer në Kosovë para dhe pas demonstratave të vitit 1968. Pjesëmarrës të Konferencës Shkencore, ishin studiues nga të gjitha viteset shqiptare, në mesin e referuesve ishin edhe vetë organizatorët dhe pjesëmarrësit e këtyre demonstratave.

1.4. Simpoziumi Shkencor Çlirimi i Kosovës, kushtuar 10-vjetorit të çlirimit të Kosovës

Në kuadër të shënimit të dhjetë vjetorit të çlirimit të Kosovës, Instituti i Historisë- Prishtinë, më 12 qershor organizoi në Prishtinë simpoziumin shkencor Çlirimi i Kosovës. Në këtë simpoziium u referuan 21 tema, të cilat kryesisht u përqendruan në ngjarjet që përfshin periudhën kohore 1989-1999, duke filluar që nga suspendimi i autonomisë së Kosovës e deri tek çlirimi i saj.

Në simpoziumin Çlirimi i Kosovës përveç studiuesve nga Kosova dhe Shqipëria, me kumtesa u prezantuan edhe shumë personalitete tjera të rëndësishme të cilët kanë qenë vetë pjesëmarrës të shumë ngjarjeve dhe proceseve të rëndësishme të cilat kontribuan në çlirimin e Kosovës.

Drejtori i Institutit të Historisë-Prishtinë prof.dr. Jusuf Bajraktari, duke ju drejtuar të pranishmeve të këtij simpoziumi, në fjalën e hapjes në mes tjerash theksoi se përpjekjet për lirinë e Kosovës, u kurorëzuan pikërisht para një dekade me çlirimin e Kosovës, andaj edhe afirmimi i vlerave të lëvizjeve çlirimtare për liri, është obligim për të gjitha institucionet e Kosovës, përfshirë edhe ato shkencore. Më pas simpoziumin e përshëndeten kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës Jakup Krasniqi si dhe ambasadori i Shqipërisë në Kosovë Islam Lauka.

Në fjalën e tij përshëndetëse Jakup Krasniqi pasi e përgëzoi Institutin e Historisë për organizimin e këtij simpoziumi, ai vuri në dukje se historiografia shqiptare ka arritur rezultate të shumta dhe të larta në studimin e së kaluarës sonë, por për shkaqe që dihen, historia më e re e Kosovës, ka mbetur më pak e ndriçuar. Ai po ashtu potencoi se është në nderin e brezit të sotëm të studiuesve, t'i hyjnë trajtimit të kësaj periudhe, sa të vështirë e tragjike, po aq edhe të lavdishme dhe vendimtare për jetën dhe fatin e këtij vendi dhe të qytetarëve të tij.

Ndërkaq Islam Lauka, ambasadori i Shqipërisë në fjalën e tij përshëndetëse vuri në pah se ndriçimi i luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është borxh për institucionet shkencore të Kosovës.

Punimet e simpoziumit shkencor u hapën me temën e prof.dr. Faruk Salihut (Prishtinë), “Suspendimi i autonomisë së Kosovës”. Në kumtesën e tij duke folur për politikën të cilën e ndoqi Serbia ndaj popullit shqiptar pas demonstratave të vitit 1981, megjithatë nuk arriti që ta shuaj dëshirën e popullit shqiptar për liri dhe pavarësi.

Me tema të tyre në vazhdim u paraqiten edhe këta studiues: Prof. dr. Fehmi Rexhepi, i cili duke folur për “Ngritjen dhe funksionimin e institucioneve të republikës së Kosovës(1990-1999), para së gjithash vuri në dukje se zanafillën e ngritjes së këtyre institucioneve duhet kërkuar në fund të viteve të 80-ta, në kohën kur Serbia po mendohej ta shuante atë autonomi të brishtë që kishte Kosova.

Agim Çeku, ish komandanti i UÇK-së, u paraqit me kumtesën “Organizimi i UÇK-së”. Ai pasi foli për organizimin e UÇK-së, tha se kjo luftë është vazhdim i përpjekjeve të lëvizjeve të hershme për lirinë e Kosovës.

Prof.dr. Jusuf Bajraktari në kumtesën e tij u ndal tek një moment mjaft i rëndësishëm i historisë së UÇK-së, tek dalja publike e saj. Prof.dr. Selim Daci, në kumtesën e tij duke folur për UÇK-ën vuri në dukje kontributin e UÇK-ës si organizatë politike ashtu edhe ushtarake. Ndërkaq Edita Tahir referoi për diplomacinë e Kosovës në kohën e okupimit.

Për kontributin e familjes Jashari dhënë në çlirimin e Kosovës referoi dr. Jakup Krasniqi. Ai duke folur për rolin dhe rëndësinë e kësaj familje për çlirimin e Kosovës vuri në dukje se është e vështirë që në një punim si ky të numërohen të gjitha meritat e kësaj familje vështirë të përsëritshme edhe në historinë botërore.

Prof.dr. Marengelen Verli në kumtesën e tij prezantoi faktorët që përcaktuan domosdoshmërinë e luftës çlirimtare në Kosovë dhe shpalljen e pavarësisë. Ramë Buja foli për ngjarjet që e karakterizuan Kosovën prej Dejtonit deri tek Konferenca e Rambujes. Për kontributin e diasporës shqiptare dhënë në çlirimin e Kosovës referoi mr. Frashër Demaj.

Me kontributet e tyre në këtë simpozium u paraqitën edhe ish komandantët e zonave operative të luftës së UÇK-së si: Sami Lush-

taku i cili foli për Zonën Operative të Drenicës, Ramush Haradinaj për Zonën Operative të Dukagjinit, Ahmet Isufi, Zona Operative e Karadakut, Rrustem Mustafa, Zona Operative e Llapit, Sabit Syla & Miftar Kurti referuan për Zonën Operative të Shalës. Për Zonën Operative të Nerodimës referoi Nehat Mustafa, ndërsa Rrustem Berisha për Luftën e Koshares.

Prof.dr. Sabile Basha në kumtesën e saj referoi për rolin që luajtën veprimtarët ilegalë të lëvizjes kombëtare në pavarësinë e Kosovës. Prof.dr. Haki Kasumi, në kumtesën e tij ofroi të dhëna për gjenocidin serbë të ushtruar në Kosovë gjatë viteve 1998-1999. Për bashkëpunimin në mes të NATO-s dhe UÇK-së referoi prof.dr. Izber Hoti, ndërsa prof.dr. Drita Gunga referoi për ndihmesën e grave dhënë në rezistencën paqësore dhe në luftë. Prof.dr. Sulltane Ukaj, në kumtesën e saj u përqendrua tek roli i arsimit në shërbim të pavarësisë së Kosovës gjatë viteve 1998-1999.

Teki Kurti referoi për prezantimin e çështjes së Kosovës në shtypin shqiptar gjatë viteve 1990-1999. Për eksodin e popullsisë së Kosovës referoi dr. Lush Culaj, ndërsa Jani Sota në kumtesën e tij na ofroi të dhëna për kontributin e Shqipërisë në përballimin e eksodit nga Kosova në vitet 1998-1999. Esilda Luku, paraqiti kumtesën Lufta e UÇK-së e pasqyruar në faqet e shtypit periodik, me theks të veçantë u ndal tek “Shekulli” dhe “Koha Jonë”. Fjalën e mbylljes së këtij simpoziumi e mbajti prof.dr. Fehmi Rexhepi.

1.5. Simpoziumi Shkencor kushtuar 130- vjetorit të lindjes së albanologut kroat Milan Shuflajt

Për nder të 130 vjetorit të lindjes së albanologut kroat Milan Shuflajt, Instituti i Historisë Prishtinë në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës organizuan në Prishtinë më 9 nëntor 2009 Simpoziumin Shkencor me temën: “Kontributi i Milan Shuflajt në studimet Albanologjike”. Në simpozium me kumtesa u paraqiten 9 referues nga Kroacia, Shqipëria dhe Kosova, të cilët vlerësuan lartë kontributin e mikut të madh të shqiptarëve-Milan Shuflajt dhënë në ndriçimin e historisë së popullit tonë, gjithnjë duke mbrojtur të vërtetën historike të shqiptarëve gjë që i kushtoi edhe me jetë.

Në simpozium përveç studiuesve dhe përfaqësuesve të insti-

tucioneve shkencore e shtetërore të Kosovës të pranishëm ishin edhe ambasadori i Kroacisë në Kosovë Zvonko Kramariq, si dhe përfaqësuesi i Ambasadës së Shqipërisë në Kosovë Xhevat Mustafa. Punimet e simpoziumit i hapi akademik Pajazit Nushi. Ai pasi vlerësoi lartë kontributin e Milan Shuflajt si medievist dhe albanolog të madh kroat, tha se ky simpozium është i pari i këtij lloji që po mbahet në Prishtinë në nderim të studiuesit të historisë mesjetare shqiptare.

Në emër të ASHAK, fjalën përshëndetëse e mbajti kryetari i ASHAK-ut, akademik Besim Bokshi, i cili vuri në dukje se ky simpozium jo vetëm që do të sjell rezultate nga këndvështrimi i sotëm i vlerës së veprës së Milan Shuflajt por njëkohësisht do të shënoi edhe praninë e respektit të pushueshëm për kontributin që dha studiuesi Shuflaj në sqarimet e çështjes shqiptare. Në emër të studenteve dhe profesorëve të Universitetit të Prishtinës punimet e simpoziumit i përshëndeti rektori i UP-së Prof. dr. Mujë Rugova. Ndërsa në emër të ministrit të MKRS të pranishmit i përshëndeti këshilltari i tij Shefki Ukaj.

Seria e kumtesave filloi me kumtesën e studiuesit të mirënjohur nga Zagrebi, prof. dr. Zvonimir Sheparoviq (Kroaci) i cili prezantoi kumtesën: " Dr. Shuflaj si viktimë e shovinizmit dhe hegjemonizmit serb". Duke folur për kontributin e Shuflajt, ai vuri në dukje se të dhënat e reja që zbuloi për shqiptarët, ndikuan edhe në likuidimin e tij nga shovinizmi serb. Ndërsa, studiuesi nga Tirana prof. dr. Pëllumb Xhufi(Tiranë) prezantoi kumtesën " Dr. Milan Shuflaj ose shpëtimi i historisë". Ai u ndal tek një moment mjaftë i rëndësishëm i kontributit të Shuflajt, duke potencuar se Milan Shuflaj zbuloi dhe deklaroi me zë të lartë të vërtetat deri atëherë të pazbuluara e të pa pohuara të historisë së shqiptarëve. Sipas tij Milan Shuflaj i pati të gjitha mjetet për të arritur tek këto të vërteta: përgatitjen sovraane, kuriozitetin dhe rigorozitetin shkencor, e mbi të gjitha guximin për ti thënë këto të vërteta. E këtë guxim dikush nuk ia fali.

Në kumtesën e tij prof. dr. Selim Daci (Prishtinë) "Dokumentacioni i Arkivit t Vjenës mbi vrasjen e Milan Shuflajt", duke ju referuar lëndës arkivore të arkivit të Vjenës potencoi jehonën që pati vrasja e këtij dijetari jo vetëm në Kroaci por edhe më gjerë.

Studiuesi i radhës prof. dr. Ferid Duka(Tiranë), në kumtesën e tij "Këndvështrimi i Milan Shuflajt për shqiptarët si faktor i historisë mesjetare", vuri në dukje se nga vepra e Shuflajt u mësua se mesjeta

shqiptare nuk ka qenë aspak një periudhë e errët, përkundrazi ajo ishte një kohë me një dinamikë shoqërore dhe politike mjaft interesante. Ndërkaq studiuesi kroat Mag. Jur. Darko Sagrak (Kroaci), në kumtesën e tij “Roli i Dr. Milan Shufflajt në lidhshmërinë e historisë kroate dhe shqiptare”. Duke folur për lidhshmërinë e historisë kroate dhe shqiptare, ai vuri në dukje se kjo viktimë e dorës serbomadhe është ndërlidhja më e fuqishme midis dy popujve tan miq. Prandaj ti ruajmë urat e miqësisë që i ka ndërtuar Shufflajt, theksoi ai.

Referuesi i radhës prof.dr. Lulëzim Lajçi (Prishtinë), në kumtesën e tij “Korrespondenca e Dr. Milan Shufflajt me mbretërinë Shqiptare”, tha se deri në shfaqjen e Shufflajt, interesimi për shqiptarët nga ana e kroatëve përcillej më shumë në nivelin publicistik.

Në kumtesën “Qytetet e bregdetit shqiptar në veprat e Milan Shufflajt”, Teuta Shala (Prishtinë), theksoi se Shufflajt na ofron të dhëna të bollshme për historinë e qyteteve si: Durrësi, Lezha, Shkodra, Drishti, Vlora, Tivari dhe Ulqini, duke na pasqyruar një tablo të plot mbi to si në rrafshin politikë, ashtu edhe në atë ekonomik, juridik, fetar, kulturor etj., të dhëna të cilat për nga vlera dhe rëndësia janë të veçanta ngase janë të bazuara në fakte dhe të argumentuara me dokumente të shumta arkivore të grumbulluara nga arkivat e atyre vendeve me të cilat në njëfarë mënyre është e lidhur një pjesë e historisë së qyteteve në fjalë.

Në fund mr. Bedri Muhadri (Prishtinë), në kumtesën “Dinastia e Balshajve në studimet e Milan Shufflat”, vuri në dukje se Milan Shufflajt ka dhënë rezultate të rëndësishme shkencore për shtetin e Balshajve të cilët patën ndikim të madh në periudhën kohore 1360-1412.

Punimet e simpoziumit u përmyllën me fjalën e drejtorit të Institutit të Historisë prof.dr. Jusuf Bajraktarit, i cili pasi çmoi lartë kontributin e referuesve të këtij simpoziumi, vuri në dukje se nuk ishte e rastit as zgjedhja e temës bosht për të trajtuar kontributin e madh të një figure lapidare të mendimeve të avancuara.

II.VEPRIMTARIA BOTUESE E INSTITUTIT TË HISTORISË-PRISHTINË 2008-2009

Krahas organizimit të konferencave shkencore, dhe simpoziumeve, në fushën e veprimtarisë shkencore të Instituti të Historisë – Prishtinë në vitet 2008-2009, është më rëndësi të veçojmë edhe një segment mjaftë të rëndësishëm nga kjo fushë atë të botimeve shkencore. Në këtë aspekt vlen të përmendim se gjatë viteve në fjalë Instituti i Historisë nxori këto botime:

- 1.Gjergj Kastrioti-Skënderbeu dhe epoka e tij, Prishtinë, 2008.
- 2.Lidhja shqiptare e Prizrenit dhe roli i saj në histori, Prishtinë, 2008.
- 3.Ali Hadri-Jeta dhe vepra, Prishtinë 2009.
- 4.Azem Bejtë Galica, Prishtinë, 2009.
- 5.Dr.Frashër Demaj, Afrim Xhuraj-jeta dhe vepra, Prishtinë, 2009.

Revista Shkencore:

- 1.Kosova 29/30, Prishtinë, 2008.

IN MEMORIAM

